

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	213 lekë për litër, çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar arrin nivelin më të lartë historik
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/213-leke-per-liter-cmimi-i-naftes-ne-mbreterine-e-ba-shkuar-arri-i1185996
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:30:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11e0b666523aa7839b6973be675783a03a29f6361dc6a486a15ffed866c58899
TEKSTI	09de7e4aab07b0ab44b98c4b768e7d4ee854f7f6134a5076aa87260d9d28f136
PAMJA	6c504d48497bb36c5498c097f93dc6677895712884520722a04581e70c73d3d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1cb196512968a1432c827779302923deaeaa7f774a2d61c2132c0c4a4072002d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1cb196512968a1432c827779302923deaeaa7f774a2d61c2132c0c4a4072002d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

213 lekë për litër, çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar arrin nivelin më të lartë historik

Nga A2 CNN
28 Shtator 2026, 13:21 | Bota



Çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar ka arritur një rekord historik prej 1,9918 pound për litër (213 lekë për litër), sipas organizatës automobilistike RAC, ndërsa lufta në Lindjen e Mesme vijon të rrisë koston e karburanteve. Edhe çmimi i benzinës vijoje në rriten, me një litër që aktualisht kushton 1,74 pound, përcjell A2 CNN.

Gjatë shtatë muajve të fundit, lufta mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara ka shkaktuar ndërprerje të mëdha në prodhimin dhe transportin e naftës në rajon, duke çuar në rritje të ndjeshme të çmimeve të karburanteve të prodhuara nga nafta. RAC tha se çmimi i naftës ka hyrë në "territor të paeksploruar", duke shërbyer si një kujtesë për "varësinë e madhe të Britanisë së Madhe nga ngjarjet që ndodhin shumë larg saj".

Çmimi i naftës është rritur tashmë me gati 40% që nga shpërthimi i konfliktit mes SHBA-së dhe Iranit në fund të shkurtit. Rekordi i mëparshëm ishte 1,9909 pound për litër, i regjistruar në qershor 2022.

Rritja do të thotë se mbushja e një automjeti familjar mesatar me naftë kushton tashmë rreth 110 pound, ose 31 pound më shumë se në fillim të konfliktit.

Benzina kushton aktualisht 0,41 pound për litër më shumë se në fillim të konfliktit, por çmimi i saj mbetet ende ndjeshëm nën rekordin e vitit 2022.

Të dhënat e RAC bazohen në çmimin mesatar të naftës në një sërë supermarketesh, pikash karburanti në autostrada dhe shitësish të pavarur.

Edhe Rusia, një tjetër prodhues i madh i naftës, ka vendosur një ndalim të eksporteve të naftës, pas sulmeve të Ukrainës ndaj rafinerive të saj, duke kufizuar më tej furnizimin.

Nafta është më e vështirë për t'u rafinuar se benzina dhe, për shkak se përdoret gjerësisht nga industria e transportit të mallrave dhe në bujqësi, është shumë e vështirë të reduktohet kërkesa për të.

Mbretëria e Bashkuar është shumë e varur nga importet. Edhe pse katër rafineritë në vend prodhojnë më shumë benzinë sesa nevojitet për konsum, ato nuk prodhojnë mjaftueshëm naftë për të përbushur nevojat e vendit.

Sipas të dhënave të Departamentit për Transportin, në fund të qershorit, në rrugët e Mbretërisë së Bashkuar qarkullonin 15,1 milionë automjete me naftë. Kjo shifër është më e ulët se një vit më parë, kur ishin 15,7 milionë. (A2 Televizion)

TE FUNDIT

Pas fazës së parë, Universiteti i Vlorës po tërheq edhe studentë të huaj

🕒 "Nuk është se nuk do, kaq cilësi ka"! Ilir Alliu ka rezerva për Kristjan Asllanin: Nuk u ngrit atje ku prisnim

🕒 Begaj tregon konkluzionet e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit: Institucionet jo në garë me njëri-tjetrin, t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigjojë vetveten

Viti i kalit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe 193 fjalime

MË TË VIZITUARAT

Surprizë e madhe në Nations League, Greqia mund Gjermaninë për herë të parë...

Vrasja e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar, shtyhet sean...

Pas humbjes me Belgjikën, Italia lë pushim 10 lojtarë, gati për duelin me Tur...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Ministri izraelit, komandantit të Hamasit:
Do të të ekzekutoj



Kaja Kallas ngre alarmin: Moska po
përgatit akte sabotimi



Irani paralajmëron SHBA-të: Jemi gati për
"luftë apokaliptike", por dera për
diplomacinë mbetet e hapur



Mbi 700 mijë vetë mbushin sheshin në
Paris, Papa në meshën gjigante, vlerëson
entuziazmin dhe përkushtimin



Britania e Madhe në alarm, eksplozivë në
bazën e përdorur nga SHBA, disa të
arrestuar



Trump refuzoi propozimin për Hormuzin,
Teherani: Vetëm diplomacia i jep fund
konfliktit

Latest Videos



"Begaj merr urdhëra nga Rama, nuk e ftoi Berishën në Këshillin e Sigurisë Kombëtare"

Trondit Kalaja! Afere sek*suale me zyrat e shtetit. SHBA po godet, Rama ka rene...



"Rama i ka hipur kalit mbrapsht, asnjë vend i BE nuk e lë Shërbimin Informativ në dorë të mafias"



"Agasi filmonte kush i hynte në zyrë, i shantazhonte, SPAK ka video të rënda"

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.